ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **KEK-26-1171-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Riparimi dhe shtellimi (testimi) I valvave siguruese te kaldajes per bl (A3 – A5)**

A N K E S Ë

Identifikimi i ankuesit*

Grupi i OE "B&D ENGINEERING SH.P.K. & Specijalna oprema Lučko d.o.o. & NOVAMAT SH.P.K."
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr."Nënë Tereza" nr.4
(Adresa)

Fushë Kosovë — *(Vendi)*

12000 — *(Kodi postar)*

+383 44136578 — *(Numri Telefonit)*

— *(Numri i Faks-it)*

Shaban Hoti
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

b_dengineering@yahoo.com
(Adresa elektronike)

19.11.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Riparimi dhe shtellimi (testimi) I valvave siguruese te kaldajes per bl (A3 – A5).**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 07.05.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 01.06.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë në datën 27.10.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 02.11.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 09.11.2026 ka publikuar vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës tonë ku sipas këtij vendimi shihet se AK e ka refuzuar kërkesën tonë si të pabazuar.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët**.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [X]

Hapja e tenderëve është bërë në datën 01.06.2026. Në procesin e hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë në datën 27.10.2026. Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 02.11.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim. AK me datë 09.11.2026 ka publikuar vendimin lidhur me shqyrtimin e kërkesës tonë ku sipas këtij vendimi shihet se AK e ka refuzuar kërkesën tonë si të pabazuar. Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullte kohorë, po i drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 21 të RRPP-001/2022 versioni i amandamentuar;

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së Nr. 04/L-042 dhe nenin 43 të RRPP-001/2022;

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së Nr. 04/L-042;

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së Nr. 04/L-042;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1. **AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së** pasi që gjatë administrimit me procedurën e prokurimit, procesit të vlerësimit të ofertave dhe anulimit të tenderit, nuk ka luajtur aspak rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Krejt kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit. Përpos kësaj, anulimi i tenderit shihet se është bërë pa asnjë bazë ligjore dhe pa e trajtuar drejt ofertën tonë edhe pse kemi qenë dhe jemi tenderues plotësisht i përgjegjshëm. Kjo tregon qartë se përpos që AK po e shkel ligjin, po vepron edhe në kundërshtim me të gjitha parimet e mira të prokurimit. Thirrja kinse në ofertën tonë si të papërgjegjshme dhe mos njoftimi si duhet i OE për ndryshime që ishin bërë në dokumentet e tenderit, tregon se AK po e përdor vetëm si arsyetim fiktiv këtë çështje dhe për pasojë po tenton të e anuloj kundërligjshëm tenderin. Këtu po shihet qartë se qëllimi i vetëm është eliminimi i tenderit tonë dhe privimi jonë nga marrja e kësaj kontrate. Pra mos publikimi i njoftimit adekuat mbi ndryshimet e bëra në Listën e Çmimeve dhe mos publikimi i Formularit standard për korrigjimin e gabimeve (formulari B54) e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të dispozitave që flasin për administrimin e mirëfilltë me procedurat e prokurimit nga çka shihet qartë se AK nuk po vepron as sipas rregullave për vlerësimin, sqarimin dhe krahasimin e drejtë të tenderuesve, e ku për pasojë po e shkel plotësisht nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

Pretendimi 2. **AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së** ku gjatë vlerësimit të tenderit të tonë po aplikon kriteret dhe kërkesa në mënyrë të gabuar duke na diskriminuar hapur edhe pse jemi tenderues plotësisht i përgjegjshëm si dhe kemi çmimin shumë të arsyeshëm dhe brenda buxhetit të parashikuar.

Sipas rrjedhës së procesit, po shihet qartë se AK ka bërë ndryshime në listë të çmimeve por që ndryshimet e tilla nuk i ka njoftuar si duhet dhe për ndryshimin e tillë nuk ka aplikuar si duhet njoftimin përmes formularit standard për njoftimin e tenderuesve mbi ndryshimet e tilla. Me që ndryshimi i tillë nuk është bërë në formë ligjore, atëherë nuk duhet konsideruar fare dhe për bazë duhet të merret gjendja fillestare e dosjes së tenderit dhe ajo e formularit të çmimeve. Me që ndryshimi i tillë konsiderohet i pa njoftuar si duhet dhe me që AK do duhej marrë për bazë formularin e çmimeve që e kishte publikuar fillimisht, atëherë i bie se aplikimi i këtij kriteri për eliminimin tonë është shkelje edhe e nenit 56.3 të LPP i cili e ndalon eliminim e tenderuesve për diçka që nuk është kërkuar. Pavarësisht kësaj dhe me që tenderi jonë e plotëson mjaftueshëm shërbimin që është kërkuar edhe me formularin e ndryshuar, AK është dashur të kërkoj sqarime nga ne për atë që kemi ofertuar. Pra me që AK ka mundur ta sqaroj këtë çështje duke aplikuar nenin 59.4, dhe 72 të LPP-së, konsiderojmë se ne jemi diskriminuar hapur nga mos aplikimi i drejt i këtyre neneve si mundësi, nga çka rezulton me shkelje të plotë neneve të cekura dhe të nenit 7 të LPP-së.
Detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të prokurimit, gjatë ndryshimeve në dokumente pa i formalizuar ato në mënyrë ligjore si dhe gabimeve gjatë vlerësimit të tenderëve, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

Pretendimi 3. **AK ka shkelur nenin 21 të RRPP-001/2022 dhe nenin 2.7 të UPP-001/2023** ku gjatë administrimit me procedurën e prokurimit ka bërë ndryshime në listën e çmimeve të cilat nuk i ka publikuar fare në platformën e prokurimit publik përmes **formularit standard B54**. Ndryshimet e tilla AK i ka përmendur vetëm tek një përgjigje në pyetjen e një OE-ve por që për të njëjtat nuk ka aplikuar publikimin e rregullt dhe ligjor siç e parasheh legjislacioni i prokurimit. Ja si e përshkruan këtë detyrim neni 21.7.a dhe 21.7.b i RRPP-001/2022:

> 21.7 Njoftim për informata shtese ose përmirësim gabimi
>
> a. Nëse një AK siguron informata shtesë për Operatoret Ekonomik ose bënë një përmirësim të gabimit, ndryshim të dosjes së tenderit, listës së çmimeve/paramasën ose zgjatë afatin e dorëzimit të tenderit, gjatë udhëheqjes se aktivitetit të prokurimit përmes procedurës së hapur, kufizuar, konkurruese me negociata ose kuotim të çmimit, ZP do të përgatis *Njoftimin për informata shtese, duke përdorur formularin standard B54 të aprovuar nga KRPP.*
>
> b. AK duhet të publikoj të gjitha njoftimet për informata shtesë në sistemin e prokurimit elektronik të Kosovës.

Përpos kësaj, këtë detyrim të AK-së e përshkruan edhe neni 2 i UPP-001/2023 mbi operimet në sistemin e prokurimit elektronik i cili qartë e thotë se:

2.7 Ashtu siç është përcaktuar në RRPP, paragrafi 24.7, "Njoftimi për informata shtesë ose përmirësim gabime (B54)", përdoret për ndryshim ose përmirësim të Dosjes se Tenderit, Listës së çmimeve, të dhënave në njoftim për kontratë dhe zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, atëherë, zyrtari i prokurimit udhëzohet që gjatë përgaditjes dhe publikimit të formularit B54 të plotësoj vetëm të dhënat e nevojshme varësisht nga qëllimi. P.sh:

a) nëse korrigjimi ka të bëjë me DT dhe të dhënave në Njoftim për kontratë atëherë ndryshohet/plotësohet vetëm pjesa tekstuale e cila duhet të ndryshohet në të dy dokumentet.

b) Nëse korrigjimi ka të bëjë me Listën e çmimeve, atëherë Lista e çmimeve e ndryshuar ngarkohet tek pjesa e listës së çmimeve, ndërsa në formularin B54 tek pjesa "informacionet shtesë" vetëm specifikohet qëllimi i publikimit të korrigjimit (ndryshimi i listës së çmimeve).

Pra me që këtë njoftim nuk e ka bërë në formë të rregullte dhe për pasojë ne nuk kemi pranuar ndonjë e-mail mbi ndryshimin e listës së çmimeve, atëherë i bie se AK duhet ta pranoj si të mirëqenë listën e çmimeve që ne kemi aplikuar sepse lista e tillë e përmbushë mjaftueshëm kërkesën e AK-së. Shto këtu faktin se asgjë nga lista e vjetër e çmimeve që ne kemi aplikuar nuk e atakon listën e re të çmimeve por përkundër kësaj ofron më shumë për AK-në, atëherë AK është dashur ta pranoj si devijim minor të cilin ka mundur ta sqaroj ose ka mundur edhe ta pranoj si të tillë pa pasur nevojë të shkoj në anulim të tenderit. Pra mos aplikimi dhe mos publikimi si duhet i ndryshimeve në dokumentet e tenderit, ka ndikuar që ne mos ta shohim ndryshimin e tillë dhe të aplikojmë me listën e vjetër nga çka tregon qartë se AK ka shkelur plotësisht nenin 21.7 të RRPP-001/2022.

Pretendimi 4. **AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së** pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit dhe lista e çmimeve ashtu siç ishin publikuar fillimisht duke mos i pranuar disa devijime minore të tenderit tonë si të mirëqena. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. **Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:**
(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose
(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit;

me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Sipas dosjes së tenderit ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara por pavarësisht kësaj AK na ka eliminuar si të papërgjegjshëm për një devijim minor që ka ardhur si pasoj e mos informimit si duhet nga ana e AK-së me ndryshimet e bëra në listën e çmimeve pas publikimit. Për ta elaboruar më lehtë si shkelje, fillimisht po i paraqesim arsyen e eliminimit të tenderit tonë:

ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:

Gjatë fazës së publikimit të procedurës së prokurimit, është bërë ndryshimi i përshkrimit të çmimit për pozicionin nr. 6, i cili është ngarkuar në platformën E-Prokurimit si ndryshim i dosjes së tenderit.
Për këtë ndryshim, operatorët ekonomikë janë njoftuar në mënyrë zyrtare edhe përmes sqarimeve (pyetje & përgjigje), në përputhje me procedurat e parashikuara.
Megjithatë, ju keni dorëzuar ne ofertën tuaj përshkrimin e mëparshëm të publikuar në fazën e parë, dhe jo në versionin e ndryshuar dhe të vlefshëm të Dosjes së Tenderit.
Një veprim i tillë është në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe ndryshimet e publikuara zyrtarisht, andaj oferta e juaj konform Neni 17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara të procedurës së prokurimit dhe konsiderohet e papërgjegjshme.

Bazuar në këtë që është shkruar në arsyetimin për cilësim të tenderit tonë si të papërgjegjshëm, konsiderojmë se AK nuk ka respektuar fare nenin 59.4 të LPP-së dhe nuk ka aplikuar drejt as dokumentacionin e tenderit përkatësisht formularin e listës së çmimeve që është dashur ta merrte për bazë. Këtë e themi për faktin se AK në mënyrë jo të rregullt kishte ndryshuar listën e çmimeve gjatë tenderimit pa na njoftuar në formë zyrtare dhe pa aplikuar fare dispozitën 21.7 të RRPP-001/2022. Ligjërisht dihet se kur një ndryshim apo modifikim i një dokumenti bëhet jashtëligjshëm dhe pa i njoftuar palët, ndryshimi i tillë nuk mundet të aplikohet gjatë vlerësimit dhe se në rastin konkret del që AK është dashur ta aplikoj listën e vjetër të çmimeve. Përpos kësaj dhe bazuar në atë që ne kemi ofertuara përmes listës fillestare të çmimeve, shihet se asnjë nga elemente që i posedon lista e re e çmimeve nuk mungojnë në listën fillestare që ne kemi aplikuar. Përkundër asaj ato që ne kemi ofruar janë benifit për AK-në dhe konsiderohet vetëm si mundësi shtesë e përdorimit nga ana e tyre nëse do kishin interes.

Për të parë më saktë se për çka bëhet fjalë po e pasqyrojmë pozicionin 6 të listës së çmimeve ashtu si duhej në listën fillestare dhe si duket te liste ndryshuar:

Lista fillestare e çmimeve	Lista e ndryshuar e çmimeve
Të riparohen dhe shtellohen valvat siguruese të avullit rikthyes në Δ 62 m: - Riparimi i valvave përmbanë (demontimin , ndërrimin e puthitësave,pastrimin e pjesëve nga korrozioni ,kontrollimin-përpunimin- polirimin e sipërfaqeve puthitëse.Kontrollimin e sustave të valvave, testimin e sustave te valvave , pastrimin e pjesëve nga korrozioni dhe nese gjatë defektazhit vrehen dëmtime të saldohen,të përpunohen-polirohen dhe të funksionalizohen për punë efektive në prodhim. Kontrollimin e sipërfaqeve puthitëse të kokave puthitëse-sicave,përpunimin e sipërfaqeve puthitëse te sicave dhe nese gjatë defektazhit vërehen risa të thella të saldohen,të përpunohen-polirohen dhe të funksionalizohen për punë efektive në prodhim pastaj montimi dhe shtellimi). - shtellimi i valvave bëhet me metoden kompjuterike, - presioni për shtellim është ..... p = 22 bar , - diametri i jashtëm i gypit në hyrje të valvës .... Dh = 185 mm, - diametri i jashtëm i gypit në dalje të valvës .... Dd = 220 m, - mediumi : ..... avull , - prodhuesi i valvave : ..... " Bopp Reuther " Gjermani , foto nr.06,07. - pas perfundimit të punëve të lëshohet çertifikata e punës.	Të shtellohen valvat siguruese të avullit rikthyes në Δ 62 m: - shtellimi i valvave bëhet me metoden kompjuterike, - presioni për shtellim është ..... p = 22 bar , - diametri i jashtëm i gypit në hyrje të valvës .... Dh = 185 mm, - diametri i jashtëm i gypit në dalje të valvës .... Dd = 220 m, - mediumi : ..... avull , - prodhuesi i valvave : ..... " Bopp Reuther " Gjermani , foto nr.06,07. - pas perfundimit të punëve të lëshohet çertifikata e punës

Pra po shihet se AK ka larguar nga lista e çmimeve riparimin e valvulave dhe ka lënë vetëm shtjellimin e tyre. Ne kemi ofruar një çmim të caktuar për riparimin dhe shtjellimin e tyre të cilit do i përmbahemi pavarësisht asaj se a duan apo jo AK-ja ta riparojnë valvulën siguruese.

Pra ne kemi ofertuar duke aplikuar listën fillestare dhe kjo nuk paraqet asnjë devijim apo ndryshim në implementim të kontratës. AK nëse dëshiron mundet ta merr si shërbim riparimin por nëse nuk dëshiron mundet edhe të mos e merr. Ne jemi të gatshëm që me çmimin e dhënë të realizojmë tërë shërbimin e paraparë në këtë rubrikë/pozicion varësisht nga kërkesat e AK-së.
Pavarësisht kësaj dhe me që kontrata detyrimisht duhet implementuar sipas detyrimeve të Aneksit 1 nga dosja e tenderit dhe me që ne kemi dorëzuar specifikimin e tillë të nënshkruar dhe vulosur si dhe kemi dhënë edhe deklaratë se do të i përmbahemi atij specifikimi teknik gjatë implementimit të kontratës, tregon se lista e çmimeve nuk ka asnjë efekt negativ në këtë rast dhe se devijimi i tillë konsiderohet absolutisht vetëm një devijim minor. Realisht dhe ligjërisht kjo duhet të konsiderohet si devijim minor për faktin se sqarimi i tijë që ishte detyrim i AK-së, **nuk ndryshon kushtin material apo aspektin e tenderit** si dhe devijimi i tillë **nuk shkakton asnjë ndryshim material ose devijim në karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera** të parashtruara në njoftimin e kontratë e veçanërisht ato në dosjen e tenderit.

Pra kjo tregon se ndryshimi apo devijimi i tillë nuk e bënë tenderin tonë aspak të papërgjegjshëm dhe se realisht AK do duhej pranuar si të rregullt nga çka do rezultonte edhe me shpalljen e tenderit tonë si fitues. Të gjitha dëshmitë që tregojnë se ne do të i përmbahemi specifikimit teknik të aneksit 1 i gjeni të bashkangjitura në tenderin tonë ku përpos tjerash është Aneksi 1 i nënshkruar dhe vulosur si dhe deklarata me të cilën zotohemi se do i përmbahemi plotësisht specifikimeve teknike si e nënshkruar dhe vulosur.

Se tenderi jonë do duhej pranuar si i përgjegjshëm dhe do duhej që të shpallej edhe fitues e tregon edhe fakti se asnjëri nga tenderuesit tjerë nuk është i përgjegjshëm. Këtë e themi veçanërisht kur i shohim me kujdesë dokumentet e tenderuesve tjerë që ishin konkurrent.

Më detalisht po e tregojmë shkurtimisht se pse ishin të papërgjegjshëm këta tenderues duke pasqyruar disa nga mangësitë e tyre:

- **Mangësi** e tenderuesit **ATB GROUP SHPK** konsiderohet mungesa e dëshmive mbi projektet e realizuara, mungesa e certifikatave ISO, mungesa e stafit të certifikuar, mungesa e certifikatës LAGATEST dhe mos vazhdimi i validitetit të tenderit të cilat tenderuesin në fjalë e bëjnë të papërgjegjshëm.

- **Mangësi** e tenderuesit GOE "**UNIVERS-M SH.P.K. & ICI d.o.o."** konsiderohet mungesa e dëshmive mbi projektet e realizuara dhe mungesa e listës së projekteve, mungesa e certifikatave ISO, mungesa e stafit të certifikuar dhe mungesa e certifikatës LAGATEST të cilat tenderuesin në fjalë e bëjnë të papërgjegjshëm.


- **Mangësi** e tenderuesit GOE "**ND SH.P.K. & DOO MIS SISTEM CENEJ & RAMM VENT DOO & DOO NS-TERMOMONTAZA"** konsiderohet mungesa e listës së projekteve të realizuara, mungesa e certifikatave ISO, mungesa e stafit të certifikuar, mungesa e certifikatës LAGATEST, gabimi në deklaratën nën betim ku mungon mbiemri i pronarit të kompanisë, nënshkrimi nga një person me në autorizim jo adekuat dhe në emër të pronarit të kompanisë pa e vendosur emrin e vet fare, mos vazhdimi validitetit të tenderit, mos dorëzimi i deklaratës së formimit të grupit etj të cilat tenderuesin në fjalë e bëjnë të papërgjegjshëm.

Pra me që nga dosjet e këtyre tenderuesve po shihet se të gjithë janë të papërgjegjshëm dhe me që vetëm tenderi jonë realisht konsiderohet se plotëson të gjitha kriteret e kërkuar për tu pranuar si i përgjegjshëm, tregon se AK do duhej që të e shpallte si fitues tenderin tonë. Shto këtu faktin që dy nga tenderuesit e kishin edhe çmimin më të lartë se ne, ndërsa ai që posedonte çmimin më të ulët ishte komplet i papërgjegjshëm dhe nuk kishte vazhduar të jetë palë e interesit duke mos vazhduar validitetin e tenderit, e forcon edhe më shumë detyrimin e AK-së që neve të na shpallte si fitues.

Mos veprimi sipas ligjit dhe mos vlerësimi, sqarimi dhe krahasimi i tenderuesve saktë sipas asaj që ishte publikuar ligjërisht në sistemin e prokurimit elektronik, tregon se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

Pretendimi 5. **AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP-001/2022** me rastin e anulimit të tenderit dhe shkelja e tillë vjen si pasojë e mos respektimit të nenit 7, 56, 59, dhe 72 të LPP-së që AK nuk i ka respektuar fare gjatë vlerësimit. Po që se do respektoheshin si duhet kriteret e dosjes së tenderit dhe vlerësimi do bëhej në përputhje me nenet e cekura më lartë, AK do kishte një Grup të OE që i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderi dhe që posedon edhe çmimin më të ulët se sa buxheti i paraparë, kështu që nuk do ishte fare e nevojshme për ta anuluar tenderin. Pas analizimit dhe verifikimit të ofertës tonë dhe krahasimin e sajë me atë që ishte kërkuar AK në dosjen e tenderit por edhe me atë që AK ka theksuar kur na ka eliminuar si të papërgjegjshëm del që tenderi jonë i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga AK dhe është plotësisht i përgjegjshëm. Me që u sqarua se edhe lista e çmimeve nuk përbën asnjë problem në implementim të kontratës dhe se gabimi tek lista ka ardhur për fajin e vet AK-së, tregon edhe më shumë se AK po aplikon anulimin e tenderit në mënyrë të paligjshme dhe të panevojshme.

Nisur nga kjo që u tha më lartë, lirisht mund të konstatohet se aplikimi i anulimit të tenderit është duke u bërë në kundërshtim me realitetin që mbretëron tek procedura në fjalë. Arsyetimi i anulimit të tenderit që AK e ka publikuar duket kështu:


Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., anulon këtë aktivitet te prokurimit, pasi që asnjë oferte nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit rrjedhimisht te gjitha ofertat janë te papërgjegjshme.

Ky arsyetim nuk përputhet me asnjë nga mundësitë reale që i ofron neni 62 i LPP-së dhe neni 43 i RRPP-001/2022 për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Duhet ceket edhe kjo se asnjeri nga Legjislacioni Primar / as Sekondar që ishte në fuqi kur ka filluar procesi i prokurimit e që duhet aplikohet deri në mbyllje të këtij aktiviteti nuk ofron mundësi të anulimit të tenderit për arsye të tilla sepse shihet qartë nga lista e çmimeve që ne kemi ofruar të gjitha ato që vet AK i ka kërkuar.

Ja si duken mundësitë që i ofron LPP dhe RRPP-001/2022 për ndërprerje të aktivitetit të prokurimit pas hapjes publike:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

Ndërsa sipas RRPP-001/2022 përkatësisht nenit 43, mundësitë për anulim duken kështu e që sipas anulimit shihet se AK e ka keq aplikuar dispozitën nr. 43.7 të RRPP-001/2022:

43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

43.7 Procedura e prokurimit ***pas hapjes së ofertave*** **mund** të anulohet për arsyen e mëposhtme:

a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Arsyetimi i AK-së se gjoja ne kemi ofertuar me listën e çmimeve të gabuar nuk qëndron sepse nga sqarimi detal i arsyes së eliminimit u kuptua se faji për këtë gabim është i vet AK-së dhe se lista jonë ofron më shumë përveç atyre që AK i ka paraparë në listën e ndryshuar.

Nisur nga kjo nuk kemi se si të mendojmë ndryshe për veç asaj që AK po shkelë plotësisht nenin 62 të LPP dhe nenin 43 të RRPP-001/2022.

Pretendimi 6. **AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së** sepse nuk ka respektuar kërkesat e nenit në fjalë e sidomos ato që kanë të bëjnë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pasi që nuk i ka trajtuar drejt dëshmitë që disa OE kanë ofruar. Këtë nen AK e ka shkelur plotësisht edhe kur ka bërë vlerësimin e tenderit tonë pasi që edhe përkundër se i kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë që tregojnë se ne do i përmbahemi Aneksit 1 të Dosjes së tenderit , na eliminon për diçka krejt të pa rëndësishme që më shumë konsiderohet devijim minor i disa të dhënave,
Me vetë faktin që ndryshimet e bëra në listën e çmimeve nuk janë publikuar si duhet dhe me që ndryshimi i tillë nuk përbënë fare mangësi të asaj që ne kemi ofruar, tregon hapur se AK nuk i ka respektuar kërkesat e vendosura në përputhje me këtë nen andaj me plot kuptim mundemi të konstatojmë se AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderit tonë.

Pretendimi 7. **AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së** pasi që gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime edhe pse shihet ka pasur paqartësi të theksuar lidhur me listën e çmimeve që ne kemi dorëzuar. Nenin 72 i LPP shumë qartë e thotë se:

Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Po ashtu ky nen e thotë edhe këtë se:

> Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Në rasatin tonë shihet qartë se gabimi i tillë ka ardhur për fajin e vet AK-së dhe se ne kemi ofruar të gjitha ato që vet AK i ka kërkuar andaj AK ka pasur detyrim ligjor të kërkoj sqarime dhe më pas devijimet e tilla të i konsideroj si minore duke na shpallur fitues me që ishim edhe tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm në këtë tenderit. Pra me që asnjë ndryshim material nuk do të ndodhte në tenderin tonë dhe me që devijimi i tillë nuk do të shkaktonte asnjë ndryshim substancial të tenderit, tregon se realisht ishin plotësuar kushtet e nenit 72 të LPP-së që të kërkohej sqarime shtesë. Pra bazuar në këtë dhe në atë që e thotë dispozita në fjalë, mos kërkimi i sqarimeve shtesë e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 72 të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që thamë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar **ankesa** e **Grupit të OE "B&D ENGINEERING SH.P.K. & Specijalna oprema Lučko d.o.o. & NOVAMAT SH.P.K."** lidhur me tenderin "**Riparimi dhe shtellimi (testimi) I valvave siguruese te kaldajes per bl (A3 – A5)**" i iniciuar nga **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së kërkesat e dosjes së tenderit si dhe specifikimet teknike të **Aneksit 1,** e që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej **Grupi i OE B&D ENGINEERING SH.P.K. & Specijalna oprema Lučko d.o.o. & NOVAMAT SH.P.K."**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë. Kosto e përgatitjes së tenderit dhe e kontestimit të vendimit të AK-së pa e përfshi fitimin e munguar dhe shpenzime tjera, arrin vlerën e përgjithshme mbi 12,000.00€

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Dosja e Tenderit - Shqip
- 3 Pershkrimi cmimeve - Shqip nga webi
- 4 Pyetje - Pergjigje - Shqip
- 5 Pyetje - Pergjijge 2 - Shqip
- 6 Pyetje - Pergjijge 3 - Shqip
- 7 Proces verbali i hapjes se Tenderve
- 8 Raporti i Vlersimit te tenderve - 1
- 9 Raporti i Vlersimit te tenderve - 2
- 10 Vendimi i AK
- 11 KËRKESË PËR RISHQYRTIM - KEK - B&D - 02.11.2026
- 12 Pergjigje ndaj kerkeses per rishqyritm e pa bazuar

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*